ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **I.K. I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS**
Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**711-25-2974-2-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Digjitalizimi i arkivës dhe shërbimit të librezave sanitare-LOT 2"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

CMD SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Nena Terezë, 40a, nr.2

(Adresa)

Prishtinë **10000**

(Vendi) *(Kodi postar)*

+383-44-631-998 **N/A**

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Zejnullah Fetahu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

contact@cmdsoftwares.com

(Adresa elektronike)

30.06.2025

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

CMD SH.P.K PRISHTINE

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 18.04.2025 Data e hapjes së ofertave: 16.05.2025 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 16.06.2025 Kërkesa për rishqyrtim dt:19.06.2025 Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dt:23.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja elektronike në platformën e E-Prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 66 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 Për prokurim Publik.
Neni 10 i Udhëzues Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin të AK-së me dt.16.06.2025, ku është rekomanduar për kontratë OE **"DataProgNet" SH.P.K ,** ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar.

Arsyet e eliminimit janë si në vijim:

Tenderi i juaj është refuzuar

- ❑ Nuk i keni përmbushur kërkesat teknike të përcaktuara neni 3.1 FDT dhe Aneks 1 dosj tenderite sigurisë së tenderit;

ARSYETIM

Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me kërkesat teknike
Kerkesat teknike
Neni 3.1 Specifikacionet teknike të detyrueshme - FDT
Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës duke përfshirë:
a. Deklaratën për specifikacionet teknike për shërbimet/mallrat e ofruara të cilat përputhen me a të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;

Arsyetimi i dhënë nga ana e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertë tonë bazohet në pretendimin se nuk janë përmbushur kërkesat teknike të përcaktuara në nenin 3.1 të Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT) dhe Aneksit 1 të dosjes së tenderit.

Ky arsyetim është i pabazuar në ligj dhe në dokumentacionin përkatës të tenderit, për këto arsye thelbësore:

Fillimisht AK ka përdorur një dokumentacion të pasaktë dhe jo në harmoni me dokumentet standarde
Autoriteti Kontraktues ka hartuar dhe përdorur për këtë aktivitet prokurimi një dosje të tenderit që nuk është në përputhje me dokumentin standard të miratuar nga KRPP për këtë lloj procedure. Konkretisht:

1.PËRDORIMI I DOKUMENTACIONIT TË TENDERIT NË KUNDËRSHTIM ME STANDARDET E MIRATUARA NGA KRPP

- Aktiviteti i prokurimit është zhvilluar si **procedurë e hapur – shërbime**, për të cilën duhet të ishte përdorur **Dosja e tenderit B16 – Dosja e tenderit për shërbime –**

Vlera e parashikuar	2.4	*[shëno vlerën e parashikuar te kontratës]*
Variantet	4.1	*Variantet [shëno "nuk do të" apo "do të"]* autorizohen *[Nëse variantet janë të autorizuara, shëno:]* a. Tenderuesit janë të autorizuar që të dorëzojnë një tender duke propozuar një variant që përputhet me një variant të specifikimeve teknike. Tenderuesit duhet të dorëzojnë specifikimet teknike të variantes se ofruar. Specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga ndonjë variant janë të shënuara në specifikimet teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 1.

procedura e hapur.

*(insert nga FDT te **Dosja e tenderit B16 – Dosja e tenderit për shërbime – procedura e hapur)***

https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/SecondaryLegislation/shq/B/B16.docx

Vlera e parashikuar	2.4	**55000,00€** Vlera e parashikuar sipas lloteve **Llot 1 – 25000.00€** **Llot 2 – 30000.00€**
Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofru të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për shërbimet/mallrat e ofruara të cil përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;
Variantet	4.1	*Variantet autorizohen:* **Po** ☐ **Jo** ☒

*(insert nga FDT te **Dosja e Tenderit Arkiva LS Sh K e përdorur nga ana e AK)***

- Megjithatë, AK ka aplikuar elemente nga **B15 – Dosja e tenderit për furnizime**, duke përfshirë kërkesa dhe referenca (si neni 3.1 i FDT-së) që nuk ekzistojnë dhe nuk janë të aplikueshme sipas dokumentacionit standard për shërbime.

Vlera e parashikuar	2.4	*[shëno vleren e parashikuar te kontartes]*
Specifikacionet teknike të detyrueshme	3.1	Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit.
Variantet	4.1	*Variantet [shëno "nuk do të" apo "do të"]* autorizohen *[Nëse variantet janë të autorizuara, shëno:]* a. Tenderuesit janë të autorizuar që të dorëzojnë një tender duke propozuar një variant që përputhet me një variant të specifikimeve teknike. Tenderuesit duhet të dorëzojnë specifikimet teknike të variantes se ofruar. Specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga ndonjë variant janë të shënuara në specifikimet teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 1.

(insert nga FDT te Dosja e tenderit B15 – Dosja e tenderit për Furnizime – procedura e hapur) https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/SecondaryLegislation/shq/B/B15.docx

- **Shkelje e nenit 6 dhe 7 të LPP-së (parimi i ekonomicitetit, efikasitetit dhe trajtimit të barabartë)**
  Duke përdorur dokumentacion jo standard dhe duke vendosur kritere të papërcaktuara qartë në dosjen e tenderit për shërbime, AK ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe ka rrezikuar të dështojë qëllimin e procedurës dhe të cenojë parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.
- **Pretendimi për mangësi mbi bazë të kritereve të paaplikuara ligjërisht**
  Vendimi për eliminimin e ofertës sonë është bazuar mbi një dispozitë (neni 3.1 FDT) e cila **nuk ekziston në FDT-në e dokumentit standard për shërbime (B16)** dhe rrjedhimisht nuk mund të përdoret si bazë për eliminimin tonë.
- **Cenimi i sigurisë juridike dhe krijimi i konfuzionit për operatorët ekonomikë**
  Vendimi për eliminim është mbështetur mbi një dispozitë (neni 3.1 i FDT) e cila nuk ekziston në dokumentacionin standard për shërbime dhe si e tillë nuk ka fuqi juridike për të qenë bazë për eliminim.
- Ky përdorim i paautorizuar i dokumentacionit dhe referencave të gabuara përbën **cenim të rëndë të sigurisë juridike** të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi.

- Përfshirja e kërkesave të paqarta, të paaplikuara ligjërisht dhe jashtë standardit, krijon **lajthitje të theksuar dhe konfuzion për operatorët**, duke pamundësuar përgatitjen e një oferte në përputhje me kërkesat ligjore dhe duke cenuar besimin e OE-ve në rregullsinë e procedurës së prokurimit publik.

2.APLIKIMI I KËRKESAVE TË PAAUTORIZUARA DHE KUNDËRLIGJORE NË FDT

Një tjetër element thelbësor që bën të pavlefshëm arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë lidhet me faktin se **kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit që AK përmend në vendimin e eliminimit nuk ka qenë pjesë e kërkesave të përcaktuara për Operatorët Ekonomikë, ashtu siç janë të paraqitura në dosjen e tenderit dhe në NJOFTIMIN PËR KONTRATË të publikuar nga vetë Autoriteti Kontraktues.**

Më konkretisht:

- Në dokumentacionin e dosjes së tenderit, në seksionin **"KËRKESAT që duhet të plotësohen nga Operatorët Ekonomikë"**, nuk figuron asnjë referencë apo kërkesë specifike që të obligojë ofertuesit të dorëzojnë deklarata apo dokumente të tilla (p.sh. dorëzimi i kodit burimor, dokumentacionit të bazës së të dhënave, manualeve të përdorimit apo garancive për dorëzim të kodit), siç janë pretenduar në vendimin për eliminim.
- Po ashtu, **në njoftimin për kontratë të publikuar nga AK në platformën zyrtare**, nuk figuron asnjë kërkesë e tillë teknike që të ishte e njohur paraprakisht për Operatorët Ekonomikë dhe që do të mund të shërbente si bazë ligjore për eliminim në fazën e vlerësimit të ofertave.

Ky fakt përbën një **cenim të parimeve themelore të prokurimit publik**, përfshirë:

- **Parimin e transparencës**, pasi ofertuesve nuk u është bërë e ditur paraprakisht një kërkesë e tillë;
- **Parimin e trajtimit të barabartë**, sepse nuk është garantuar që të gjithë operatorët kanë garuar në kushte të qarta dhe të njëjta;
- **Parimin e ligjshmërisë**, pasi një vendim për eliminim nuk mund të bazohet mbi kritere që nuk janë bërë pjesë zyrtare e dokumentacionit të tenderit apo e njoftimit për kontratë.

Në këto rrethana, **eliminimi i ofertës sonë për shkak të mosparaqitjes së dokumentacionit të paparashikuar në dokumentet zyrtare të prokurimit është i paqenë ligjërisht dhe përbën shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullave të zbatueshme.**

Shtimi kundërligjshëm i një kërkese që nuk parashihet të jetë pjesë e FDT-së:

- Një tjetër arsye themelore që e bën vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë të paarsyeshëm dhe të kundërligjshëm, është fakti se **AK ka shtuar një kërkesë të re teknike (neni 3.1), e cila nuk parashihet as në dokumentacionin standard të dosjes së tenderit dhe as në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT).**

3. Specifikimet teknike të detyrueshme	3.1 Shërbimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit, shih Aneksin 1, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, sasitë, modelet mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera. 3.2 Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikoj tenderin.

- Dokumenti standard i dosjes së tenderit për shërbime – procedura e hapur, siç është miratuar nga KRPP dhe parashikuar në legjislacionin sekondar, **nuk parashikon që një kërkesë e tillë të jetë pjesë e FDT-së dhe as të shërbejë si kriter eliminues në fazën e ofertimit.**

- Në këtë rast, **AK ka shtuar një kërkesë të paautorizuar dhe të pa përcaktuar si pjesë e FDT-së**, duke devijuar nga dokumenti standard dhe duke vendosur një kriter të ri në mënyrë të njëanshme dhe kundër normave të prokurimit publik.

Ky veprim i AK përbën:

- **Cenim të parimit të ligjshmërisë dhe respektimit të dokumenteve standarde të prokurimit**, të cilat janë të detyrueshme për AK.
- **Cenim të sigurisë juridike të operatorëve ekonomikë**, duke krijuar pasiguri dhe rrezik të eliminimit mbi kritere të paautorizuara dhe të paqena në dokumentacionin zyrtar të tenderit.

Për këtë arsye, vendimi i eliminimit të ofertës sonë mbi një bazë të tillë **është i kundërligjshëm dhe i paqenë në pikëpamje ligjore**, dhe kërkojmë që ky vendim të anulohet, ndërsa oferta jonë të rivlerësohet mbi bazën e kërkesave reale dhe të ligjshme të tenderit.

3.DËMTIMI I INTERESIT PUBLIK FINANCIAR PËRMES ELIMINIMIT TË OFERTËS MË TË FAVORSHME

-Cenimi i parimit të ekonomicitetit dhe efikasitetit me eliminimin e ofertës më të favorshme financiarisht

Një tjetër fakt thelbësor që e bën vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë të padrejtë dhe të pabazuar është cenimi i parimeve të ekonomicitetit dhe efikasitetit, të sanksionuara në nenin 6 të Ligjit për Prokurimin Publik.

- Siç del qartë nga vendimi për shpërblim të tenderit, **oferta jonë (CMD SH.P.K.) ka qenë financiarisht më e favorshme**, duke ofruar një çmim prej **14,160.00 €,** krahasuar me ofertën e OE të shpërblyer (DataProgNet SH.P.K.), e cila ka qenë **17,818.00 €.**

- Diferenca prej **3,658.00 €** përfaqëson një përfitim të konsiderueshëm buxhetor për Autoritetin Kontraktues, nëse oferta jonë do të ishte shqyrtuar dhe vlerësuar drejt dhe në përputhje me kriteret ligjore e reale të tenderit.
- Eliminimi i ofertës sonë mbi arsye të pabazuara dhe të paautorizuara ka sjellë:
  Cenim të drejtëpërdrejtë të interesit publik, pasi është shpërblyer një ofertë më e shtrenjtë pa një arsye ligjore të qëndrueshme.
  Shkelje të nenit 6 të LPP, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë përdorim efikas dhe ekonomik të fondeve publike.
  Rrezik të dështimit të qëllimit të procedurës së prokurimit, duke i shkaktuar dëme potenciale buxhetit të shtetit dhe duke cenuar konkurrencën e ndershme në treg.

Për më tepër, kjo situatë thekson edhe më fort se eliminimi i ofertës sonë nuk ka qenë i diktuar nga kërkesa reale e dokumenteve standarde të tenderit, por nga shtimi i një kërkese të paautorizuar dhe të pabazuar, që në fund ka çuar në shpërblimin e një OE-je me ofertë më të lartë financiarisht.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se arsyet e eliminimit tonë nga ana e AK-së janë të gjitha të paqëndrueshme dhe të pa bazuara, andaj kërkojmë që të analizohen në tërësi të gjitha dokumentet tona dhe njëkohësisht të respektohen të gjitha dispozitat ligjore të LPP-së dhe pastaj të merret një vendim meritor në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse oferta jonë është e përgjegjshme dhe i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

1. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e **CMD SH.P.K.**
2. **ANULOHET,** njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
3. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 3,000.00€.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
e) *B16 Dosja e Tenderit – Shërbime - Procedura e hapur (dokumenti stendat nga KRPP)*
f) *Dosja e Tenderit Arkiva LS Sh K (dokumenti i publikuar nga AK)*

CMD SH.P.K PRISHTINË

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*